

VENDIM
Nr. 230, datë 26.4.2018

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË DREJTËSISË TË
NJË PJESE TË GODINËS, AKTUALISHT NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË
KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËR RIKONSTRUKSIONIN E HYRJES KRYESORE PËR KOLEGJIN
E POSAÇËM TË APELIMIT DHE KOMISIONERËVE PUBLIKË, INSTITUCIONE TË
RIVLERËSIMIT TË GJYQITARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13, 14 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë të një pjese të godinës, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për rikonstruksionin e hyrjes kryesore për Kolegjin e Posaçëm të Apelit dhe Komisionerëve Publikë, institucione të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas të dhënave të pasurisë dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ministria e Drejtësisë nuk mund ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

PLANIMETRIA SH 1:100



